



**QUEEN'S
UNIVERSITY
BELFAST**

T'i ndihmojmë fëmijët!

Buletin Informativ

Pranverë 2018

QËLLIMET & HISTORIKU

Këtë vit ekipi hulumtues “T'i ndihmojmë fëmijët!” zgjeroi projektet e tyre ‘Lojërat e Emërimit’. Fokusi i këtij projekti është të kuptojmë se si dhe kur fëmijët fillojnë të njohin emrat, simbolet dhe sinjalet tjera sociale brenda kontekstit të tyre kulturor. Përveç zhvillimit të hulumtimit në Irlandën Veriore, projekti u zgjerua edhe në dy kontekste shtesë: Kosovë dhe Maqedoni.

Studimet u fokusuan në fëmijë të grupmoshave pesë deri në njëmbëdhjetë vjeç. Gjithsej 732 fëmijë nga Irlanda Veriore, 214 fëmijë nga Kosova dhe 124 nga Maqedonia ishin pjesë e studimit. Secili fëmijë ka luajtur një numër lojërash të përshtatshme për moshën në laptop apo tablet, i ndihmuar nga një anëtar i trajnuar i ekipit tonë hulumtues. Fëmijëve u janë bërë pyetje rreth preferencave të tyre, çfarë pritjesh kanë për preferencat e një personi tjetër dhe kanë kategorizuar emra e ikona të ndryshme.

Derisa analizat e studimit janë ende duke u zhvilluar, ne jemi të ngazëllyer që po eksplorojmë mënyrën se si fëmijët e vendeve të ndryshme fillojnë t'i njohin simbolet e tyre kulturore përgjatë fazave të ndryshme të zhvillimit të tyre.

Irlanda Veriore: Tri lojëra

Në Irlandën Veriore, studimi u zgjerua tutje në tri lojëra të ndryshme që kishin fokus paksa më të ndryshëm.

E para, e titulluar ‘Simbolet dhe Shenjat’, kishte të bënte kryesisht me preferencat e fëmijëve ndaj fotografive, simboleve dhe ikonave të ndryshme karakteristike për Irlandën Veriore. E dyta, e titulluar ‘Ku përkasin këto?’ inkurajonte fëmijët të kategorizonin fotografitë në kategori dhe etiketime të ndryshme sociale sipas mënyrës që ata mendonin se do të duhej. Loja e tretë, e titulluar ‘Nga çka përbëhet një emër?’, fokusohet në një numër emrash të cilët historikisht i janë atribuar një kulture të caktuar.

Përmes të tri lojërave, ne eksploruam se si fëmijët fillojnë të njohin këto sinjale sociale gjithnjë e më në detaje teksa rriten.



NJIHUNI ME EKIPËN

Universiteti Queen's Belfast:

Laura Taylor, Ph.D.
Jocelyn Dautel, Ph.D.
Risa Rylander, MA

Universiteti Kolegji Amerikan Shkup, Maqedoni:

Ana Tomovska Misoska,
Ph.D.

Universiteti RIT Kosovë (A.U.K), Kosovë:

Edona Maloku ,Ph.D.
Kandidate



NGA ÇKA PËRBËHET NJË EMËR?

Kjo lojë fokusohet në emrat të cilët zakonisht asociohen me sfonde të ndryshme kulturore në Irlandën Veriore.

Rezultatet nga kjo lojë tregojnë se sa më shumë rriten fëmijët, ata çdo herë e më shumë preferojnë emrat nga sfondi i komunitetit të tyre, janë në gjendje t'i kategorizojnë emrat e komunitetit të tyre me më shumë saktësi, dhe janë më të prirur të ndajnë resurset e tyre me anëtarët e komunitetit të tyre.

Megjithatë, rezultatet po ashtu tregojnë që nëse fëmijët kanë përvoja pozitive me fëmijët nga një komunitet tjetër, atëherë ata tregojnë më shumë gatishmëri që të ndajnë resurset e tyre me fëmijët nga grupet tjera sociale, përfshirë këtu edhe fëmijët që nuk i njohin personalisht.



Përgjatë tri lojërave, sa më të rritur të jenë fëmijët ata kuptojnë dhe njohin më mirë sinjalet sociale në Irlandën Veriore.

KU PËRKASIN KËTO?

Loja 'Klasifikimi i Hapur' inkurajonte fëmijët që të organizojnë imazhet e ndryshme nëpër kategori. Përpilimi i kësaj lojë ishte më i veçantë sepse lejonte që përgjigjet e fëmijëve të jenë më pak të strukturuar.

Ngjashëm me dy lojërat tjera, rezultatet tregojnë se sa më të rritur të jenë fëmijët, ata bëhen më të vetëdijshëm rreth asocijimeve kulturore që kanë simbolet dhe ikonat e zakonshme si flamujt, sportet dhe aktivitetet që zhvillohen në komunitet.

Analizat e mëtejme të këtij pyetësi do të na ndihmojnë të kuptojmë më mirë se cilat ikona janë konjitivisht më të qasshme përgjatë moshave të ndryshme.

SIMBOLET & SHENJAT

Për dallim nga tjerat, loja 'Simbolet & Shenjat' fokusohej në imazhet dhe ikonat e ndryshme kulturore të cilat janë të pranishme në gjithë Irlandën Veriore.

Rezultatet nga ky pyetësor tregojnë se sa më shumë që rriten fëmijët, ata janë në gjendje që të kategorizojnë imazhet me më shumë saktësi dhe zhvillojnë një preferencë karshi imazheve nga sfondi i tyre kulturor.

Rezultatet gjithashtu tregojnë se sa më shumë që fëmijët kishin dëshirë të luanin me fëmijë nga sfonde të tjera kulturore, aq më të gatshëm ishin që




Which one do you like better?

☐ This is a shamrock.



☐ This is a poppy.





Bashkëpunëtorët tanë nga Kosova dhe Maqedonia, në rajonin e Ballkanit në Europë

LOJËRAT E BALLKANIT

Kosova

Lojërat në Kosovë ishin më të ngjashmet me pyetësin e Simboleve të realizuar në Irlandën Veriore, me disa pjesë shtesë. Këto lojëra së pari janë përkthyer në dy gjuhët zyrtare të vendit, shqip dhe serbe.

Rezultatet tregojnë të gjetura të ngjashme me ato të Irlandës Veriore. Teksa fëmijët rriten dhe zhvillohen, ata njohin më lehtë simbolet e ndryshme sociale dhe zhvillojnë një preferencë për emrat dhe ikonat e komunitetit të tyre kulturor. Gjithashtu, preferencat e fëmijëve për të ndarë resurset e tyre me fëmijët nga komuniteti i njëjtë zvogëlohen kur fëmijët kanë më shumë përvoja dhe bashkëveprime pozitive me fëmijë nga një komunitet tjetër.

Prapaveprimi nga shkollat

Pëlqimi i prindërve është dhënë për të gjithë fëmijët që morën pjesë në këto lojëra. Gjithashtu, në fillim të çdo seance studimi, secili fëmijë është pyetur nëse dëshiron të marrë pjesë në aktivitetet. Fëmijët shpesh kanë theksuar se iu kanë pëlqyer shumë lojërat dhe mundësia për t'u përgjigjur në pyetje!

'Ky studim ishte një përvojë tërësisht e re për nxënësit në klasën time. Ata asnjëherë më herët nuk kanë marrë pjesë në një projekt hulumtues, prandaj ky aktivitet ishte një përvojë tërësisht e re dhe inovative. Pjesëmarrja në lojëra, mundësia për të fituar shpërblime dhe 'certifikimi' si shkencëtarë të rinj u dëshmuar si shumë motivuese për ta. Ata kaluan orë duke biseduar rreth aktivitetit pas përfundimit të tij. Ishte kënaqësi të jemi pjesë e një projekti kaq të rëndësishëm që ndihmon përmirësimin e raporteve dhe ndërtimin e paqes në vendin tonë. Mendoj se kemi shumë nevojë për këtë.

- Mësimdhënëse në një shkollë fillore në Prishtinë / Kosovë

PAK HISTORIK: KOSOVA

- ◆ Lufta në Kosovë zgjati nga 1998 – 1999.
- ◆ Në vitin 2008, Republika e Kosovës shpalli pavarësinë.
- ◆ Sot, shumica e popullsisë së Kosovës janë shqiptarë dhe një numër i vogël janë serbë.
- ◆ Shkollat në Kosovë janë të ndara sipas gjuhës kryesore që nxënësit e flasin: shqip ose serbisht.

Which one do you like better?

☐ This is Flja.



☐ This is Sarma.



IKONAT LOKALE

Imazhet dhe emrat e përdorur në secilin shtet partner i janë përshtatur kulturës dhe kontekstit lokal. Për shembull, disa lloje të ushqimeve janë më të zakonshme për disa rajone në Kosovë se sa për të tjerat, si shembulli i dhënë në fotografinë e sipërme.

PAK HISTORIK: MAQEDONIA

- ◆ Maqedonia fitoi pavarësinë në vitin 1991.
- ◆ Momentalisht pjesa më e madhe e popullatës së Maqedonisë identifikohen si maqedonas, ndërkaq një numër më i vogël identifikohen si shqiptar.
- ◆ Klasat në Maqedoni ndahen varësisht nga gjuha që e flasin më së shumti nxënësit: maqedonisht ose shqip.

STUDIME SHITESË

Ekipi hulumtues i projektit *T'i ndihmojmë fëmijët!* do të vazhdojë të analizojë rezultatet e këtij studimi dhe të eksplorojë tutje të gjeturat!

T'i ndihmojmë fëmijët! është i përfshirë vazhdimisht në një numër fushash. Për shembull, disa nga projektet tona përfshijnë eksplorimin e sjelljeve dhe qëndrimeve pro sociale të fëmijëve si simpatia dhe empatia.

Për më shumë informata rreth fushave që projekti *T'i ndihmojmë fëmijët!* hulumton, ju lutem vizitoni uebsajtin tonë apo kontaktoni drejtpërdrejtë një nga anëtarët e ekipit!

Na kontaktoni!

Shkolla e Psikologjisë
Ndërtesa David Kier
BT7 1NN

Uebfaqja jonë: <http://helpingkidsqubblog.wordpress.com>
Tel: 0289097309
Email: helpingkids.qub@gmail.com

Maqedonia

Lojërat e Maqedonisë ishin po ashtu të ngjashme me pyetëtorin e Simboleve të realizuar në Irlandën Veriore. Ngjashëm me pyetëtorin në Kosovë, edhe në këtë rast janë përkthyer në dy gjuhët dominuese në Maqedoni: maqedonisht dhe shqip.

Rezultatet e pyetësorit nga Maqedonia po ashtu kanë paraqitur një lidhje të dukshme në mes të moshës së fëmijëve dhe njohjes së simboleve sociale të cilat i përkasin njërës komunitet ose tjetrit.




This is a boy from Macedonia. He is Macedonian. Which one does he like better?

● This is a statue of Cyril and Methodius.



● This is a statue of Naim Frasheri.



JU FALEMNDERIT!

Në emër të ekipit të *T'i ndihmojmë fëmijët!* dhe Universitetit Queen's në Belfast, duam të shprehim vlerësimin tonë të sinqertë dhe të falënderojmë secilin individ që ka përkrahur këtë projekt. Jemi shumë falënderues për entuziazmin, bashkëpunimin dhe përfshirjen e udhëheqësve dhe mësimdhënësve të shkollave fillore të cilët kanë punuar me ne.

Po ashtu, do të donim të falënderonim të gjithë nxënësit dhe prindërit për pjesëmarrjen e tyre pa të cilët ky studim nuk do të ishte i mundur.

Gjithashtu, do të donim të përmendim partnerët tonë ndërkombëtar, shkollat dhe nxënësit për kontributin e tyre të veçantë për këtë hulumtim. Një falënderim i veçantë i dedikohet koordinatorëve ndërkombëtar të projektit, Ana Tomovska Misoska dhe Edona Maloku dhe ekipeve të tyre të mrekullueshme: Ardit Zllatku, Ratka K Joseva, Lina Rogac, Eva Baramacheva, Bisera Nikolova, Meri Cvetanoska, Besa Arifi, Krenare Lleshi, Andela Mirkovic dhe Genta Shabani.

Ky projekt, *T'i ndihmojmë fëmijët!* Promovimi i bashkëveprimeve pozitive ndërgrupore dhe ndërtimi i paqes në shoqëritë e ndara, nuk do të ishte i mundur pa përkrahjen financiare të Departamentit për Ekonomi (DfE) – Fondi për Hulumtim Sfidë Globale (GCRF) Vendimi (DFEGCRF17-18/Taylor).